

DREJTORIA ARSIMORE E FILADLEFIAS

ZYRA E SUPERINTENDENTIT

440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301
PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

WILLIAM R. HITE, JR., Ed.D.
SUPERINTENDENT

27 Tetor 2016

Të dashur Prindër/Kujdestarë:

Ne jemi vënë në dijeni që Unioni Lokal 234 i Punonjësve të Transportit ka autorizuar një grevë të SEPTA_s në datën 1 Nëntor, nëse një kontratë e re nuk është pranuar deri në orën 11:59 pm, të ditës së Hënë datë 31 Tetor 2016. Ndërsa SEPTA është optimiste që një marrëveshje do të mund të arrihet deri në këtë datë, Drejtoria Arsimore e Filadelfias është e përkushtuar që në rast të një greve, të ofrojë një mjedis mësimor të rregullt dhe të sigurtë për fëmijët tuaj. Ju lutemi lexoni informacionin më poshtë dhe vazhdoni të dëgjoni “KYW” 1060 am, të Njoftimeve të Qytetit të Filadelfias, si dhe të monitoroni uebsajtin tonë www.philasd.org; dhe telefononi në linjën e hapur për prindërit (School District Parent Hotline) në numrin 215-400-INFO (4636).

ORËT E SHKOLLËS: Në rast të një greve nga SEPTA, të gjitha shkollat, zyrat dhe mjediset mbështetëse do të punojnë me orar të rregullt.

SHËRBIMET ME AUTOBUS: Të gjithë autobuzat e verdhëtë shkollës do të funksionojnë me orarin e përditshëm normal, por mund të rezultojnë edhe disa vonesa të pashmangëshme.

PARAQITJA E NXËNËSVE: Nxënësit, të cilët normalisht përdorin SEPTA_n, dhe e kanë të pamundur të ndjekin shkollën për mungesë të transportit, do të marrin mungesa të justifikuar. Në këtë rast do të kërkohet një shënim nga prindi, ose kujdestari. Në vazhdim, nxënësit që paraqiten me vonesë në mësim, nuk do t’ju shënohet si ardhje me vonesë. Ajo do të trajtohet si ardhje me vonesë në rast se Drejtoria konkludon që kjo vonesë nuk vjen si rrjedhojë e grevës së SEPTA_s. Ne e dimë që ju mund të keni edhe pyetje të tjera. Përgjigjet për pyetjet kryesore janë parashtruar në pjesën mbrapa të kësaj letre. Familjet janë të inkurajuar të kontaktojnë shkollat e fëmijëve të tyre për më tepër informacion specifik nga shkolla.

Në rast të një greve të zgjatur, Drejtoria Arsimore do të nxjerrë informacion shtesë sipas nevojave.

Ju falenderojmë paraprakisht për durimin dhe mirëkuptimin tuaj.

Sinqerisht,



William R. Hite, Jr., Ed.D.

WRH/dpw

Translation and Interpretation Center
10/2016

SEPTA Strike Parent Letter
Albanian

Drejtoria Arsimore e Filadelfias
Përgjigjet për Pyetjet në Lidhje me Grevën e SEPTA_s

10.27.2016

- 1. A do të jenë të hapura shkollat dhe zyrat administrative në rast të grevës nga SEPTA?**
Po. Të gjitha shkollat dhe zyrat administrative do të jenë të hapura dhe me orarin e zakonshëm.
- 2. A do të ketë mundësi që fëmija im të përdorë autobuzat e shkollës, nëse ka grevë të SEPTA_s?**
Autobuzat e verdhë të shkollës do të vazhdojnë të punojnë me orarin e zakonshëm, por prindërit duhet të presin edhe vonesa të tyre. Fatkeqësisht, mjetet e transportit të shkollës, nuk mund të transportojnë edhe nxënësit, që normalisht përdorin mjetet e SEPTA_s për në shkollë.
- 3. A do të marrë mungesë fëmija im në rast që ai/ajo nuk paraqitet në shkollë?**
Po. Nxënësit që normalisht përdorin SEPTA_n dhe nuk mund të shkojnë në shkollë për mungesë të transportit, do të marrin mungesë në pajtueshmëri me Kodin e Shkollës së Pensilvanisë.
Shënim: Kjo do të jetë një mungesë e justifikuar, e cila kërkon një shënim nga prindi/kujdestari.
- 4. Nëse fëmija vjen me vonesë në shkollë për shkak të grevës së Septa_s, si do të konsiderohet kjo?**
Nxënësit që normalisht përdorin SEPTA_n dhe nuk mund të shkojnë në shkollë në orar, nuk do marrin shënim si vonesë. Drejtori do të vendosë nëse kjo vonesë vjen si pasojë e grevës së SEPTA_s.
- 5. A do të vazhdojë fëmija im të marrë mëngjes dhe drekë?**
Po. Të gjitha programet e shërbimit ushqimor të Drejtorisë Arsimore do të funksionojnë normalisht.
- 6. A do të vazhdojnë programet jashtëshkollore, të tilla si “Comprehensive Early Learning Centers, extra-curricular clubs, dhe programet sportive gjatë grevës së SEPTA_s?**
Po. Të gjitha programet e pasditeve dhe të ditëve të Shtuna, të Drejtorisë, do të operojnë normalisht.

Prindërit, të cilët përdorin SEPTA_n për marrjen e fëmijëve pas aktiviteteve shkollore, të tilla si “Comprehensive Early Learning Centers, Beacons” dhe programe të tjera, duhet të gjejnë vetë alternativa të tjera për marrjen e fëmijëve, edhe në rast të një greve nga SEPTA.

- 7. A do të vazhdojnë programet jashtëshkollore të sporteve në rast të një greve nga SEPTA?**
Po. Aktivitetet sportive për shkollat 8_Vjeçare dhe të Mesme do të vazhdojnë normalisht; megjithatë, prindërit, nëse ata kanë përdorur SEPTA_n, duhet të gjejnë mjete alternative për transportin e nxënësve në shtëpi, pas përfundimit të ndeshjeve, ose stërvitjeve. Prindërit, veçanërisht ata që përdorin edhe vetë SEPTA_n, duhet të jenë të kujdesshëm në marrjen e fëmijëve në kohë pas përfundimit të programeve shkollore.
- 8. A do të mundet fëmija im të përdorë biçikletën gjatë grevës së SEPTA_s?**
Po. Drejtorët do të mundësojnë një vend të sigurtë për biçikletat e nxënësve që i përdorin për në shkollë. Nxënësit dhe prindërit duhet të dinë që ata do të kujdesen vetë që t’i mbyllin biçikletat me çelës dhe që shkolla nuk mban përgjegjësi në rast të dëmtimit dhe vjedhjes së biçikletave të tyre
- 9. Në rast se fëmija nuk mund të vazhdojë shkollën gjatë ditëve të grevës, si do të mundet shkolla që t’i ndihmojë ata për mësimet dhe detyrat e shtëpisë gjatë ditëve të grevës së SEPTA_s?**
Në rast të një greve, ndërsa nuk ka asnjë mundësi për ndjekjen e shkollës, Zyra e Kurrikulës, Vlerësimit & Mësimdhënies, për nxënësit e Kopështit-Klasa e 8, do të ofrojë Paketa Mësimore shtesë për lëndët Anglisht, Artet Gjuhësore dhe Matematikë. Paketat mësimore mund të gjenden në linkun e mëposhtëm: <http://webgui.phila.k12.pa.us/offices/c/curriculum/learning-packets>. Mësuesit e shkollave të Mesme do të ofrojnë paketa mësimore sipas fushave të tyre specifike. Të gjithë mësuesit mund të paraqesin detyra shtëpie dhe punë mësimore shtesë, për studim të pavarur nga nxënësit, të cilët normalisht përdorin SEPTA_n.